



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO			
Planuar / Dorezuar Prenjuna/Prodato Received/Delivered	04.03.2022	2	viti god Year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjete Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	1197/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.07/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-krjetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.07/2022 të datës 06.01.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat nga Prishtina, kundër Vendimit me Nr.13/52 të datës 29.12.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datën 04.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.07/2022 e datës 06.01.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.13/52 i datës 29.12.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij me autorizim avokat me datë 06.01.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 22/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.13/52 të datës 29.12.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi është nxjerr me shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullosës Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë së Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 17.01.2022 ka dërguar provat lidhur me çështjen në procedurë.

Sipas nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh natyrën e çështjes, me Vendimin Nr.15/2022 të datës 16.02.2022 të Kryetarit të Këshillit, është vazhduar afati për vendosje të ankesës A.nr.07/2022 të datës 06.01.2022 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 07/2022 të datës 06.01.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 31.12.2021; Vendimin me Nr.08/137 të datës 03.07.2013 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me numër Nr.08/137 të datës 03.07.2013 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Vendimin me numër Nr.05/122 të datës 23.12.2016 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Propozimin për vazhdimin e mandatit të datës 05.12.2019; Vendimin me numër Nr.02/2020 të datës 22.01.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Vendimin me numër Nr.03/117 të datës 22.01.2020 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Vendimin me numër Nr.13/52 të datës 29.12.2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 të datës 29.12.2018 për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019 të datës 03.12.2019 për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.01.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 17.01.2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019; Planin e punës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për vitin 2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2018; Raportin e punës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës të datës 14.01.2019; Formularin për objektivat vjetore nga Shërbime Gjeologjik i Kosovës; Vendimin me numër Nr.05/2016 të datës 15.12.2016 nga Qeveria e Republikës së Kosovës; Propozimin për vazhdimin e mandatit të ankuesit i datës 05.12.2019; Kërkesën për vazhdimin e mandatit për ankuesin të datës 23.09.2019; Formularin me komentet e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, Ministrit mbi vlerësimin vjetor të rezultateve në punë të zyrtarit të lartë drejtues; Përshkrimin e vendit të punës për pozitat e larta drejtuese; Raportin e punës së Shërbimit Gjeologjik të Kosovës të datës 25.09.2019; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën janar-shtator të vitit 2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultoi se ankuesi **me Vendimin Nr.08/137** të datës 03.07.2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ishte emëruar në pozitën Kryeshf Ekzekutiv në Institutin Gjeologjik të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me mandat tre (3) vjeçar. Të njëjtit me Vendimin Nr.05/122 të datës 23.12.2016 të Qeverisë së Kosovës i është vazhduar mandati i dytë për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm në Institutin Gjeologjik të Kosovës për periudhën tri (3) vjeçare respektivisht deri me datë 22.12.2019.

Qeveria e Kosovës duke u bazuar në propozimin e Ministrit të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik të datës 05.12.2019, sërish me Vendimin Nr.03/117 të datës 22.01.2020, ankuesit i vazhdon mandatin e tretë po me kohëzgjatje prej tri (3) viteve, në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës.

Në mbledhjen e mbajtur më datë 29.12.2021, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.13/52, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin Nr.03/117 të datës 22.01.2020 për vazhdimin e

mandatit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, me arsyetimin se ky vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në këtë mënyrë ankuesit i ka ndërprerë marrëdhënien e punës në shërbimin civil.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi Nr.13/52 i datës 29.12.2021 i Qeverisë së Republikës së Kosovës është nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale. Me tej thekson se ri zgjatja e mandatit të ankuesit sipas Vendimit Nr.03/117 të datës 22.01.2020, është bërë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore për Shërbimin Civil të cilat kanë qenë në fuqi, respektivisht Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Propozon që Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta anuloj Vendimin Nr.13/52 të datës 24.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke lenë në fuqi Vendimin Nr.03/117 të datë 22.01.2020 dhe të detyroj Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, që ankuesit t'ia kompensoj të gjitha pagat dhe befinicionet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në mënyrë retroaktive nga data 29.12.2021 deri në kthimin e ankuesit në punë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi i provave të lëndës ka gjetur se emërimi dhe zgjatja e mandateve të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik të Kosovës është bërë në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, si ligj i zbatueshëm në atë kohë, andaj edhe trajtimi i çështjes në ankesë bazohet në dispozita e këtij ligji dhe akteve nënligjore referuar zbatimit të tij.

Bazuar në përcaktimin ligjore sipas nenit 7 paragrafi 1 nënpargrafi 1.3 të Rregulloren Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji ka konstatuar se pozita Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës hynë në kategorinë pozitive të shërbimit civil të nivelit të lartë drejtues.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura në ankesë, ka analizuar nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës me të cilin përcaktohej se: *Sekretarët e përgjithshëm dhe pozicionet e barasvlershme me ta zgjidhen nga një listë e nëpunësve civilë të klasifikuar në pozitë të larta drejtuese sipas rregullave për klasifikimin e pozitave të përcaktuara nga ky ligj, ose në pozitë të tjera të barasvlershme në institucionet e administratës publike ose kompanitë publike dhe private, të cilët janë kandidatë për pozitën përkatëse, e cila përpilohet në bazë të aplikacioneve të pranuar pas shpalljes së një konkursi publik.* 2. *Ministria përgjegjëse për administratë publike formon Komisionin për vlerësimin e kriterëve (Komisioni) i cili përbëhet nga tre (3) sekretarë të përgjithshëm, një (1) profesor fakulteti nga lëmia përkatëse, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile. Titullari i institucionit ku është vendi i lirë, cakton dy (2) nga anëtarët e Komisionit* 3. *Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe në fund të saj i propozon ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre (3) kandidaturat më të mira. Ministria përgjegjëse për administratë publike ia dërgon titullarit të institucionit për miratim (3) kandidaturat më të mira. Për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar. Për institucionet jashtë ekzekutivit, titullari i institucionit përzgjedh një (1) nga tre (3) kandidatët e propozuar nga Komisioni.* 4.

Procedurat e hollësishme për emërimin në pozita të larta drejtuese përcaktohen me rregullore të veçantë të nxjerrë nga Qeveria.

Po ashtu Kolegji ju referua edhe Rregullores Nr.06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenit 22 ku thuhet se: 1. Nëse pas tri (3) vitesh Ministri e konsideron të kënaqshme performancën e zyrtarit të lartë drejtues, atëherë ai/ajo i drejtohet Këshillit të bashku me një arsyetim për vazhdimin e kontratës së zyrtarit të lartë për një mandat tjetër tre (3) vjeçar. Këshilli pas vlerësimit të kërkesës së ministrit dhe performancës së tri viteve të kaluara i propozon Qeverisë që të votohet për vazhdimin e kontratës së Zyrtarit të lartë drejtues. 2. Vazhdimi i kontratës së zyrtarit të lartë drejtues duhet të bëhet me vendim të Qeverisë pas rekomandimit nga Këshilli. Rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar së Rekomandimi i Këshillit për Pozita të Larta Drejtuese si dhe Vendimi Nr.03/117 i Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e mandatit të tretë të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Shërbimit Gjeologjik janë nxjerrë me datën 22.01.2020, respektivisht rekomandimi dhe vazhdimi i mandatit në fjalë për ankuesin janë bërë pasi që të njëjtit i ka përfunduar mandati i tij i dytë me datë 22.12.2019 sipas Vendimit Nr.05/122 të datës 23.12.2016 pra pas një (1) muaji. Andaj, nisur nga ky konstatim dhe në mbështetje të bazës ligjore si me lartë, rrjedhë se me përfundimin e mandatit të ankuesit sipas Vendimit Nr.05/122 të datës 23.12.2016, i njëjti e ka humbur statusin e zyrtari të lart drejtues dhe se në rastin konkret nuk ka mundur të behët ri zgjatja e mandatit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Shërbimit Gjeologjik, pasi që pozita në fjala është bërë pozitë e lirë dhe se e njëjta është dashur të plotësohet në pajtim me dispozitat ligjore të përcaktuara me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK)-Nr.17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konkretisht nenit 52 ku përcaktohet se: *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:... është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; ...është në kundërshtim me ligjin material;* dhe rrjedhimisht duke marrë parasysh konstatimin si me lart se Vendimi Nr.03/117 i datës 22.01.2020 i Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e mandatit të tretë të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshme të Institutit të Shërbimit Gjeologjike të Kosovës është nxjerrë në kundërshtim me dispozita ligjore të lartë cekura, Kolegji konstaton se Qeveria e Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.13/52 të datës 29.12.2021, ka vepruar në pajtim me nenin 53 paragrafi 1 dhe nenin 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e mbi këto arsye rezulton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë me shkelje ligjore dhe procedurale.

Andaj, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimit

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita

në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.07/2022

Ardita Percuku-Shyti

Ardita Percuku-Shyti
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Ministres për Ekonomi;
- Sekretariatit për Koordinim në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

